

VENDIM
Nr.334, datë 21.5.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.343, DATË 11.7.2002 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAJISJEN ME NUMËR TELEFONI CELULAR TË PERSONAVE
JURIDIKË, PUBLIKË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Fjala e parë e pikës 2 të vendimit nr.343, datë 11.7.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhet si më poshtë vijon:

“Përballimi i shpenzimeve nga buxheti i institucionit për telefoninë celulare t’u ofrohet edhe në dalje ndërkombëtare e pa kufizim, funksionarëve të përcaktuar në shkronjën “A” të shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për funksionarët e përcaktuar në shkronjës “B” të kësaj shtojce, përballimi i shpenzimeve të jetë jo më shumë se 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë në muaj, ndërsa për funksionarët e shkronjës “C” të kësaj shtojce, përballimi i shpenzimeve të jetë jo më shumë se 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë në muaj.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Shtojca nr.1

A.

1. Presidenti i Republikës
2. Kryetari i Kuvendit
3. Kryeministri
4. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese
5. Kryetari i Gjykatës së Lartë
6. Prokurori i Përgjithshëm

B.

1. Zëvendëskryetari i Kuvendit
2. Zëvendëskryeministri
3. Avokati i Popullit
4. Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve
5. Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit
6. Ministri
7. Drejtori i shërbimit Informativ të Shtetit

C.

1. Sekretari i Përgjithshëm në Presidencë, Kuvend, Këshillin e Ministrave
2. Drejtori i Kabinetit të Presidentit të Republikës, i Kryetarit të Kuvendit dhe i Kryeministrit, si dhe çdo funksionar i barazuar me ta në pagë apo me pagë përkatëse më të madhe a të barabartë me atë që i përgjigjet funksionit të pikës 2
3. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit
4. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave
5. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve